



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 5 Janar 2021

Nr: 3

VENDIM

**PËR
PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË SKRAPAR, ME
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E PARTISË SOCIALISTE TË
SHQIPËRISË, ZJ. MYNEVERE ENVER BRAHIMASI**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, dhe 164, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin përkatës

VËREN:

Me shkresën nr. 3655 prot., datë 16.11.2020, Këshilli i Bashkisë Skrapar, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari z. Esat Ali Pashaj, propozuar nga subjekti Partia Socialiste e Shqipërisë.

Referuar nenit 164, paragrafi 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumëmemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, për këshillin e bashkisë Skrapar, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 16, zj. Mynevere Enver Brahimasi.

Me shkresën nr. 2261 prot., datë 10.12.2020, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në këshillin e bashkisë Skrapar, zj. Mynevere Enver Brahimasi, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.



Kandidati për këshilltar përcaktuar në bazë të listës shumëmeërore të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit me numër 0057 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për anëtar, zj. Mynevere Enver Brahimasi, në këshillin e bashkisë Skrapar, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, paragrafi 2, shkronja "b" dhe paragrafi 3, shkronja "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", me shkresën nr. 2419 prot., datë 16.12.2020 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 2418 prot., datë 16.12.2020 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar, zj. Mynevere Enver Brahimasi, në këshillin e bashkisë Skrapar, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar në këshillin e bashkisë Skrapar, zj. Mynevere Enver Brahimasi

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore me shkresën nr. 12733/1 prot., datë 18.12.2020 ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar zj. Mynevere Enver Brahimasi, në këshillin e bashkisë Skrapar, e cili rezulton me status e padënuar nga gjykatat shqiptare.

Referuar nenit 49, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" këshilli i bashkisë ka kompetencën për dhënien e mandatit, anëtarit të këshillit bashkiak.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar paragrafit 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstaton se, për kandidatin për anëtar zj. Mynevere Enver Brahimasi, në këshillin e bashkisë Skrapar, të dhënat e të cilit nuk përbëjnë kusht për mos zgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit, duhet të vazhdojnë procedurat për dhënie mandati nga këshilli i bashkisë Skrapar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, dhe 164, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreun V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, "Për përcaktimin e



rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

V E N D O S:

1. Zj. Mynevere Enver Brahimasi, kandidat për anëtar në këshillin e bashkisë Skrapar, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Skrapar me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zj. Mynevere Enver Brahimasi.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisioni Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



A large, stylized blue ink signature is written over the official stamp.



Data: 5 Janar 2021

Nr. 3

Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Skrapar, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë zj. Mynevere Enver Brahimasi

3